



Pyetje të shpeshta

[Çfarë është EED?](#)

[Kë mbështesim?](#)

[Cilat lloje iniciativash mbështet EED?](#)

[Në cilat vende EED është aktiv?](#)

[Si veprojmë ne?](#)

[Cila është vlera e shtuar e EED?](#)

[Si i zgjedh EED përfituesit e granteve?](#)

[Si financohet EED?](#)

[A është eed pjesë e Bashkimit European?](#)

[Cila është filozofia e EED-së?](#)

[Si mund të aplikoj për mbështetje?](#)

[Si mund të punoj për EED?](#)

[Si mund të marr lajme mbi EED?](#)

[Si mund të aplikoj për grant?](#)

[Kur i shpall EED kërkesat për aplikim?](#)

[A duhet që kërkesa ime për mbështetje të jetë në anglisht?](#)

[Cila është shuma mesatare e një granti nga EED?](#)

[A mund ta dorëzoj aplikimin pranë EED pa përdorur formularin e aplikimit në internet?](#)

[A ekzistojnë mënyra të tjera për të aplikuar, për kandidatët siguria e të cilëve është veçanërisht e rrezikuar?](#)

[A mund të dorëzoj më shumë se dy kërkesa për mbështetje njëkohësisht?](#)

[A mund të kërkoj financim të përsëritur nga EED?](#)

[A mund eed të bashkëfinancojë një iniciativë?](#)

[Si mund të aplikoj për mbështetje emergjente?](#)

[Kur mund të aplikoj për mbështetje emergjente?](#)

[Si të kuptoj nëse kërkesa ime për mbështetje është marrë në dorëzim nga sistemi elektronik?](#)

[Si do ta kuptoj nëse aplikimi im për mbështetje është i suksesshëm?](#)

[Si mund të interesohem mbi statusin e kërkesës sime për mbështetje?](#)

[A mund të marr përgjigje për propozimin që nuk është zgjedhur për financim?](#)

[A ka eed zyra lokale ose përfaqësues në vendin tim, me të cilin/cilën mund të bisedoj lidhur me idenë ose propozimin tim?](#)

[Pse është e nevojshme të jap tre kontakte për rekomandim?](#)

[Pse është e nevojshme të jap tre kontakte për rekomandim?](#)



Çfarë është EED?

Fondi Europian për Demokraci (EED) është një organizatë e pavarur për dhënien e granteve që mbështet aktorë të ndryshimeve demokratike me fqinjë Europian dhe më gjerë. EED është një iniciativë e përbashkët e shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së. Punën e EED-së e mbikqyr Bordi i Guvernatorëve dhe Këshilli Ekzekutiv.

Kë mbështesim?

EED mbështet organizatat e shoqërisë civile, lëvizjet, mediat e pavarura dhe aktivistët individualë që punojnë drejt sistemit politik pluralist demokratik. Regjistrimi zyrtar nuk është i domosdoshëm. Ne gjithashtu mbështesim organizatat e sapoformuara ose të paregjistruara, platformat jo formale, individët dhe grupet rinore. Në veçanti, EED ndihmon ata që nuk mund të mbështeten nga donatorë të tjerë apo nga instrumentet ekzistuese të BE-së. EED punon në bazë të kërkesave për mbështetje dhe u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të aktorëve demokratikë lokalë. Përfituesit e drejtpërdrejtë të EED-së përfshijnë lëvizjet dhe aktorët pro-demokratikë, grupet civile dhe organizatat e shoqërisë civile, organizatat joqeveritare, mediat e pavarura, gazetarët dhe blogerët, artistët dhe grupet rinore.

Cilat lloje iniciativash mbështet EED?

Mandati i EED-së është “të nxisë dhe të inkurajojë demokratizimin dhe demokracinë cilësore dhe të qëndrueshme” në vendet që përballen me tranzicion demokratik ose mungesë të demokracisë, në rajonin e Fqinjësisë së BE-së dhe më gjerë. Shembuj të aktiviteteve të mbështetura nga EED përfshijnë, ndër të gjitha:

- Promovimi i pluralizmit politik dhe diversitetit
- Rritja e llogaridhënies së shtetit
- Rritja e gjithëpërfshirjes në shoqëri, ndër të tjera edhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe minoriteteve, dhe duke rritur pjesëmarrjen e tyre
- Mbështetja e përfaqësimit dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, si në nivelin kombëtar, po ashtu edhe në atë lokal
- Promovimi i një roli të rritur, më efektiv dhe më profesional i aktorëve pro-demokratikë, siç janë partitë politike, sindikatat dhe organizatat e shoqërisë civile



- Promovimi i lirive themelore, përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e asociimit, lirinë e tubimit paqësor dhe lirinë e fesë ose besimit

Në cilat vende EED është aktiv?

EED kryesisht punon me fqinjët Europeanë (Partneriteti Lindor, Lindja e Mesme dhe Afrikën Veriore), në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi. Vendet e përshtatshme për mbështetje fqinjëve Lindore siç janë: Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina. Vendet e fqinjëve Jugore janë: Algjeria, Egjipti, Jordania, Libia, Libani, Maroku, Palestina, Siria dhe Tunizia.

Në vitin 2015, mandati i EED-së u zgjerua për të mundësuar ofrimin e granteve për aplikim nga vendet ngjitur me fqinjët lindore dhe atë jugore, varësisht nga nevojat, fondet në dispozicion dhe prioritetet politike. Këto përfshijnë shtetet si: Bahreini, Çadi, Irani, Iraku, Izraeli, Kuvajti, Mali, Mauritania, Nigeria, Omani, Katari, Arabia Saudite, Sudani dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, si dhe Kazakistani, Kirgistani, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani dhe Uzbekistani.

Në vitin 2018, EED zgjeroi mëtej veprimtarinë e saj për të përfshirë Turqinë dhe Ballkanin Perëndimor - Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën,* Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. EED mund potencialisht të shqyrtojë aplikime nga vende të tjera në të ardhmen, varësisht nga fondet në dispozicion.

Nuk është e domosdoshme që të jeni të vendosur në njërin nga këto vende, megjithatë, aktivitetet e propozuara në përgjithësi duhet të kenë përfshirje të rëndësishme të aktorëve të këtyre vendeve dhe të synojnë popullatën e tyre.

Si veprojmë ne?

EED kryesisht përqipet të mbështesë grupe dhe aktivistë, të cilët nuk mund të mbështeten nga instrumentet ekzistuese të BE-së, ose nga programe të tjera. EED është komplementare e programeve të tjera donatore. Shërben si donator plotësues i boshllëqeve të këtyre programeve, dhe synon të ofrojë mbështetje të shpejtë dhe fleksibile. EED pranon aplikime për mbështetje në çdo kohë. Nuk ka afat të caktuar!

EED mund të mbështesë individë dhe grupe të peregjistruara.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicioneve mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



EED pranon kërkesa për mbështetje në disa gjuhë: arabisht, anglisht, frengjisht, rusisht, turqisht dhe gjuhët e Ballkanit Perëndimor.

EED mund të mbështesë shpenzimet operative (pagat, shpenzimet e zyrës dhe të tjera të ngjashme, shpenzimet e komunikimit).

EED synon t'u përgjigjet aplikantëve brenda 12 javësh dhe të ofrojë përgjigje të menjëhershme për kërkesat urgjente për mbështetje.

EED është e specializuar për ofrimin e mbështetjes në mënyrë diskrete.

Cila është vlera e shtuar e EED?

EED luan rol kritik plotësues në përpjekjet e tjera të BE-së ose të vendeve anëtare për inkurajimin e demokracisë. Fleksibiliteti i EED-së, reagimi i shpejtë dhe aftësia për të ndërmarrë rreziqe i mundëson asaj të përshtatet me nevojat e veçanta dhe kontekstet sfiduese lokale. Veçantia e EED-së qëndron në kapacitetin për të vepruar në mjedise të vështira dhe ndonjëherë të rrezikshme, të cilat shpesh janë të pa-aksesueshme për donatorë të tjerë. Me qasjen e saj fleksibile, EED mund të reagojë më lehtë ndaj rrethanave të ndryshueshme në teren.

EED është gjithashtu e pozicionuar mirë për të punuar me grupe të vogla të reja, që shpesh përfaqësojnë lëvizje demokratike në fazat e hershme, dhe i ndihmon ato të ndërtojnë kapacitete për të aplikuar për skema më të mëdha financiare. Në këtë mënyrë, EED mbush një boshllëk të rëndësishëm në mbështetjen e demokracisë të ofruar nga BE-ja.

Si i zgjedh EED përfituesit e granteve?

Vendimet e financimit i merr Këshilli Ekzekutiv i EED-së gjatë mbledhjeve të rregullta. Pasi që vlerësimi është bërë nga sekretariati i EED-së, në përputhje me mandatin e organizatës. EED respekton maksimalisht balansin gjeografik në ndarjen e fondeve mes fqinjëve të jugut dhe të lindjes.

Si financohet EED?

Njëzet e tre vende europiane, të cilat janë anëtare të Bordit të Guvernatorëve të EED-së, kanë dhënë kontribut në buxhetin e programit të EED deri më tani, si edhe Kanada me anë të një granti special për Ukrainën. Buxheti operativ i EED-së mbulohet nga një grant i Komisionit Europian.



A është eed pjesë e Bashkimit Europian?

EED u themelua me iniciativën e përbashkët të shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së. Megjithatë, ajo nuk është pjesë e Bashkimit Europian por është organizatë e pavarur për dhënien e granteve.

Cila është filozofia e EED-së?

Mbështetja e EED-së bazohet në parimin e inkurajimit – dhe jo imponimit – të demokracisë, dhe mbështetjen e iniciativave lokale. Parimi themelor është se demokracia nuk mund të imponohet nga jashtë; vetëm ndryshimi që buron nga brenda mund të çojë drejt tranzicionit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës demokratik.

Si mund të aplikoj për mbështetje?

Aplikimi për mbështetje financiare është i thjeshtë. Klikoni në butonin 'Apliko për mbështetje' dhe do të drejtoheni në portalin tonë të sigurt të aplikimit ku mund të gjeni formularin dhe udhëzimet e aplikimit.

Si mund të punoj për EED?

Të gjitha vendet e lira të punës në EED shpallen në rubrikën tonë të vendeve të punës. EED ofron gjithashtu edhe numër të caktuar të praktikave të paguara vjetore. Në këtë faqe shpallen edhe tenderat e hapur për ofrimin e shërbimeve, punimeve ose furnizimit për aktivitetet e EED-së, në rastet kur hapen mundësi të këtilla.

Si mund të marr lajme mbi EED?

Ju mund të regjistroheni në listën tonë të emailit për njoftime, të cilën mund ta gjeni në këtë faqe të internetit. Gjithashtu, mund të na ndiqni në rrjetet sociale:

- [Facebook](#)
- [Twitter](#)
- [Instagram](#)
- [Linkedin](#)



Si mund të aplikoj për grant?

Aplikimi për mbështetje është i thjeshtë. Klikoni në Apliko për mbështetje/Apply for Support dhe ky link do t'ju drejtojë në portalin tonë të sigurt ku do të gjeni formularin dhe udhëzimet për aplikim.

Formularin mund ta plotësoni në disa gjuhë: arabisht, anglisht, frengjisht, rusisht, turqisht, shqip, gjuhën BHS.

Kur i shpall EED kërkesat për aplikim?

EED shyrton kërkesat për mbështetje financiare në mënyrë të vazhdueshme, prandaj aplikuesit mund të dorëzojnë kërkesat e tyre në çdo kohë. Komiteti Ekzekutiv, i cili merr vendimin përfundimtar për financim, takohet pothuajse çdo dy muaj. Në raste të justifikuara mirë, Komiteti mund të marrë vendime edhe në periudhën mes mbledhjeve të caktuara.

A duhet që kërkesa ime për mbështetje të jetë në anglisht?

Jo. EED pranon kërkesa për mbështetje në disa gjuhë: arabisht, anglisht, frengjisht, rusisht, turqisht dhe në gjuhët e Ballkanit Perëndimor.

Cila është shuma mesatare e një granti nga EED?

EED nuk ka një shkallë zyrtare të financimit. Ne zakonisht marrim kërkesa për mbështetje në shumat 10,000 dhe 150,000 euro, mirëpo kemi dhënë edhe grante nën apo mbi vlerat e lartpërmendura. Mesatarisht, mbështetja jonë varion mes 40,000 dhe 60,000 euro.

A mund ta dorëzoj aplikimin pranë EED pa përdorur formularin e aplikimit në internet?

Po. Ju mund të dërgoni formularin e aplikimit dhe formatin e buxhetit në postën elektronike secretariat@democracyendowment.eu. EED gjithashtu pranon aplikime në kopje të shtypura në adresën në vijim:

European Endowment for Democracy
Rue de la Loi 34,
1040 Brussels, Belgium.



A ekzistojnë mënyra të tjera për të aplikuar, për kandidatët siguria e të cilëve është veçanërisht e rrezikuar?

Për mbështetje financiare mund të aplikoni me formularin e sigurtë për aplikim, të cilin mund ta gjeni në faqen tonë të internetit. Megjithatë, kandidatët, siguria e të cilëve është veçanërisht në rrezik dhe të cilët nuk duan të bëjnë aplikimin përmes formularit në internet, mund të dorëzojnë aplikimin e tyre drejtpërdrejt në postën e enkriptuar elektronike:

Posta elektronike Protonmail: secretariat@signalmail.org

Posta elektronike Tutanota: secretariat@tutanota.de

Për të përfituar nga siguria e shtuar e postës së enkriptuar elektronike, duhet të përdorni postën elektronike që korrespondon me atë me të cilën do të komunikoni (p.sh përdorni postën elektronike Tutanota për të komunikuar me secretariat@tutanota.de ose Protonmail për të komunikuar me secretariat@signalmail.org).

A mund të dorëzoj më shumë se dy kërkesa për mbështetje njëkohësisht?

Në parim, mund të dorëzoni më shumë se një kërkesë për mbështetje, mirëpo përparësi do t'i jepet idesë më të mirë.

A mund të kërkoj financim të përsëritur nga EED?

Meqenëse EED plotëson programet e tjera donatore dhe vepron si donator mbushës i hapësirave në këto programe, në rrethana normale, EED nuk ofron financim të përsëritur. Sidoqoftë, mund të ketë rrethana të jashtëzakonshme kur kjo lejohet.

A mund eed të bashkëfinancojë një iniciativë?

Nëse iniciativa është në përputhje me mandatin e EED-së për të vepruar si komplementar i programeve të tjera donatore, bashkëfinancimi mund të lejohet. Kjo do të thotë se nuk ka gjasa që EED të bashkë-financojë një iniciativë që tashmë përfiton nga financime të konsiderueshme nga burime të tjera, të tilla si p.sh. Bashkimi Europian.



Si mund të aplikoj për mbështetje emergjente?

Në situata të jashtëzakonshme dhe të justifikuara qartë, EED mund të shqyrtojë një numër të kufizuar të kërkesave urgjente. Për mbështetje mund të aplikoni në faqen tonë të internetit. Për mbështetje emergjente duhet të klikoni në kutinë në fund dhe të jepni sqarim për urgjencën e kërkesës dhe pasojat e mundshme në rast se nuk i merrni fondet urgjente.

Kur mund të aplikoj për mbështetje emergjente?

Kërkesat për mbështetje emergjente duhet të kufizohen në rrethana të jashtëzakonshme dhe në kohë krize, kur financimi është urgjent dhe fleksibil nga EED mund të përbëjë ndryshim për situatën tuaj. Këto raste duhet të arsyetohen mirë (për shembull, fakti që dëshironi të filloni iniciativën tuaj sa më shpejt nuk e justifikon kërkesën për mbështetje urgjente). Nëse kërkesa juaj për mbështetje vlerësohet se nuk është urgjente, ajo do të konsiderohet brenda periudhës standarde të shqyrtimit. Ju do të merrni një mesazh automatik, i cili do t'ju informojë në lidhje me vendimin.

Si të kuptoj nëse kërkesa ime për mbështetje është marrë në dorëzim nga sistemi elektronik?

Një mesazh automatik do të dërgohet në postën tuaj elektronike për të konfirmuar se e kemi marrë në dorëzim kërkesën tuaj. Në këtë mesazh do të jetë i shënuar edhe numri juaj i referencës. Ju lutemi të përdorni këtë numër nëse interesoheni për statusin e kërkesës suaj për mbështetje.

Si do ta kuptoj nëse aplikimi im për mbështetje është i suksesshëm?

Të gjithë aplikantëve u dërgohet një përgjigje zyrtare me rezultatin e vendimit të EED-së lidhur me kërkesën për mbështetje. EED synon që aplikantëve t'u japë përgjigje përfundimtare brenda 12 javësh.

Si mund të interesohem mbi statusin e kërkesës sime për mbështetje?

Për statusin e kërkesës suaj mund të interesoheni me anë të postës elektronike secretariat@democracyendowment.eu. Gjithmonë shënoni numrin tuaj të referencës (numër i gjeneruar nga aplikimi juaj për mbështetje) në email në mënyrë që të mund



të gjurmojmë me lehtësi aplikimin tuaj për mbështetje. Ju lutemi këtë ta bëni vetëm nëse nuk keni marrë përgjigje nga ne 12 javë pas dorëzimit të kërkesës suaj.

Synimi ynë është që të gjitha kërkesat t'i shqyrtojmë brenda 8-12 javësh mirëpo ndonjëherë procesi i shqyrtimit mund të zgjasë më shumë. Sekretariati i EED-së mund të kërkojë informata ose sqarime plotësuese gjatë këtij procesi.

A mund të marr përgjigje për propozimin që nuk është zgjedhur për financim?

Edhe pse do të donim të jepnim mendimin tonë për të gjitha kërkesat e mbështetjes, për shkak të numrit të madh të aplikimeve, EED nuk ka mundësi të ofrojë sqarim të hollësishëm për çdo aplikim të refuzuar. Megjithatë, keni të drejtë të kërkonit shpjegim lidhur me refuzimin e kërkesës suaj në secretariat@democracyendowment.eu.

A ka eed zyra lokale ose përfaqësues në vendin tim, me të cilin/cilën mund të bisedoj lidhur me idenë ose propozimin tim?

EED ka selinë në Bruksel (Belgjikë) dhe nuk ka zyra lokale në vend. Megjithatë, kemi një rrjet konsulentësh në shumicën e vendeve ku punojmë. Mënyra më e lehtë për të komunikuar me EED është të na dërgoni email në secretariat@democracyendowment.eu.

Pse është e nevojshme të jap tre kontakte për rekomandim?

Me shënimin e kontakteve të rekomandimeve ju keni mundësinë të na jepni të dhënat e personave që mund të na thonë më shumë lidhur me punën dhe përvojën tuaj ose të organizatës suaj. Këta mund të jenë persona me të cilët keni bashkëpunuar më parë ose të cilët kanë përfituar nga puna juaj. Rekomanduesi mund të jetë nga cilido vend, por këshillohet të përfshini persona që nuk punojnë në organizatën tuaj ose që nuk janë anëtarë të familjes.

Duhet gjithashtu të siguroheni se personat e zgjedhur si referencë mund t'u përgjigjen pyetjeve nëse kontaktohen nga stafi i programeve të EED-së. EED nuk kontakton gjithnjë të gjithë emrat e shënuar si referencë, dhe mund të kontaktojë gjithashtu persona që nuk janë shënuar aty.